

UDHËZIM
Nr.4, datë 31.7.1992

**PËR KRITERET E PËRGJITHSHME TË MBAJTJES NË PUNË TË PUNONJËSVE GJATË
ZBATIMIT TË LIGJIT NR.7521, DATË 30.10.1991 "PËR PËRKRAHJEN SOCIALE TË
PERSONAVE QË DALIN TË PAPUNË NGA ZBATIMI I REFORMËS EKONOMIKE",
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7579, DATË 2.7.1992**

Për zbatimin e drejtë të ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale të personave që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", ndryshuar me ligjin nr.7579, datë 2.7.1992, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Për mbajtjen në punë të punonjësve organet drjtuese të personave juridikë shtetërorë duhet të mbajnë parasysh kriteret e përgjithshme të këtij udhëzimi.

2. Në përputhje me veçoritë e tyre specifike, çdo person juridik shtetëror përcakton kriteret analitike për mbajtjen në punë të punonjësve të tij.

3. Për hartimin dhe zbatimin e kriterëve analitike drejtuesit e personave juridikë duhet të konsultohen me sindikatat.

4. Kriteret e përgjithshme për mbajtjen në punë të punonjësve janë:

a) Shkalla e aftësisë profesionale

Të mbahet parasysh shkalla e aftësisë profesionale në përputhje me kërkesat e vendit të punës, si dhe niveli i arsimimit personal.

Sipas këtij kriteri, mundësi më të madhe për të vazhduar punë kanë punonjësit me shkallë më të lartë arsimimi personal dhe aftësimi profesional.

b) Vjetërsia në punë

Si rregull nënkuptohet vjetërsia e përgjithshme në punë dhe vjetërsia në punë në personin juridik shtetëror, ku del i papunë. Sipas këtij kriteri, mundësinë më të madhe për të vazhduar punë ta kenë punonjësit që, së pari, kanë vjetërsi pune më të madhe në personin juridik shtetëror ku dalin të papunë, dhe së dyti, punonjësit që kanë vjetërsi pune të përgjithshme më të madhe.

c) Moshë

Sipas këtij kriteri, pa lënë mënjane moshat e reja, mundësinë më të madhe për të vazhduar punë ta kenë punonjësit në moshë relativisht më të madhe, që kanë mundësi më të pakta kualifikimi dhe rikualifikimi për një profesion të ri.

ç) Gjendja familjare

Sipas këtij kriteri, mundësinë më të madhe për të vazhduar punë ta kenë punonjësit, të cilët kanë një numër relativisht të madh personash në ngarkim.

5. Personat juridikë shtetërorë, që kanë të punësuar ish-të përndjekur politikë, t'u japin këtyre përparësi në mbajtjen në punë.

6. Personat juridikë shtetërorë që kanë të punësuar punonjës me banim në qytet e në fshat, përparësi në mbajtjen në punë t'u japin punonjësve me banim në qytet.

7. Personat juridikë shtetërorë, sipas mundësive të tyre ekonomike-financiare, të përpiqen për të mbajtur në marrëdhënie pune invalidët, gratë shtatazëna dhe të rinjtë pa prindër.

8. Kriteret e përgjithshme të këtij udhëzimi të vlerësohen dhe të zbatohen në lidhje me njëri-tjetrin.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi